



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 29/07/2019

Ref.: 1354/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

I. Validohen programet e studimit të Kolegjit IBCM për periudhën 1 tetor 2019 – 31 dhjetor 2022:

- Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë, Bachelor Profesional, 210 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
- Menaxhim i Shërbimeve Publike, Bachelor Profesional, 210 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
- Shitje dhe Marketing Ndërkombëtar, Bachelor Profesional, 210 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik

II. Validohet programi i studimit të Kolegjit IBCM për periudhën 1 tetor 2019 – 31 dhjetor 2025:

- Menaxhim Ndërkombëtar dhe Lidërsip, MSc, 120 ECTS, maksimumi 132 studentë për vit akademik

III. Obligohet Kolegjit IBCM që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy etimi

I. Kolegji IBCM ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmive të ofruara, rreth akreditimit dhe validimit të këtij institucioni nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit IBCM
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

